

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 859 Prot.

Tiranë, më 19.062017

VENDIM Nr. 114, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*BY-Pass Vlorë*", KM 10+420-12+100, Kaninë-Vlorë, Faza I, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*BY-Pass Vlorë*", KM 10+420-12+100, Kaninë-Vlorë, Faza I, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit për projektin "BY-Pass Vlorë" Faza I, KM 10+420-11+100, Kaninë-Vlorë, për të cilin janë kryer sondazhet arkeologjike, duke lidhur akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të zbatimit, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Për Fazën e II, KM 11+100-KM 12+100, Kaninë, e cila aktualisht nuk është shpronësuar, do të kryhen në momentin e lirimit të zonës 30 sondazhe arkeologjike, sipas Konceptit të kryerjes së sondazheve arkeologjike, të miratuar më parë për këtë zonë.
5. Shoqëria "K.A.E.XH" sh.p.k." duhet të lajmërojë ASHA, në momentin e lirimit të zonës së sipërpërmendur, e në vijim do të kryhen sondazhet sipas akt-marrëveshjes përkatëse, të lidhur më parë për këtë zonë.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO